



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.12.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. APK-DPKI-06-1451/24, për zyrtarin publik z. Sead Mujovi, Ekspert për kontroll financiar- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin publik z. Sead Mujovi, Ekspert për kontroll financiar ne Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/1-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): “z. Sead Mujovi aktualisht është anëtar i Bordit në KOSTT, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, para disa vite. Me datë 01.08.2024, është zgjedhur dhe ka marrëdhënie pune të re ne Komisionin Qendror Zgjedhor(KQZ) në pozitën Ekspert për Kontroll, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike. Andaj, sipas Ligjit. Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, Neni 14. Bordi i Drejtorëve të Operatorit të Sistemit te Transmetimit gëzon pagë citoj pika 16, se Kryesuesi dhe Anëtarët e Bordit përcaktohet Paga nga Kuvendi. Pra z. Mujovi krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar publik, respektivisht ekspert për kontroll, certifikim dhe kontroll financiar të subjekteve në Komisionin Qendror Zgjedhor(KQZ) ushtron edhe funksionin e Anëtarit Bordit të Drejtorëve ne KOSTT-it, që gëzon (2) dy paga dhe nuk është ne pajtim me nenin 22, paragrafi 3 dhe 5 Ligjit Nr.06/11 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik [...]”.

Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1451/24, e ka njoftuar zyrtarin z. Sead Mujovi, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimit të ngritur nga raportuesi i rastit për zyrtarin publik z. Sead Mujovi, ekspert për kontroll financiar në KQZ, është organizuar dhe mbajtura një takim me zyrtarin në fjalë, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit të ngritura për konflikt të interesit.

Në takim, zyrtari publik ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë duke theksuar se : *“ Pozita të cilën e kryej si ekspert për kontroll financiar është në kuadër të Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiarë të Subjekteve Politike, dhe si e tillë nuk është pozitë udhëheqëse. Ndërsa sa i përket pagës si Anëtar i Bordit në KOSTT-ë, theksoi se tarifa e pagës është përcaktuar me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me rastin e emërimit si Anëtar i Bordit”.*

Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit në dispozicion, rezulton se z. Mujovi ushtron pozitën ekspert për kontroll financiar në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, dhe njëkohësisht është anëtar i bordit të drejtorëve, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut SH.A (KOSTT).

Bazuar ne dokumentacionin në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit sqaron se nga cilësia anëtar i bordit të drejtorëve në KOSTT, z. Mujovi ka status të zyrtarit të lartë publik, në kuptim të nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i LPKI-së, me të cilin përcaktohet se: *“Zyrtar i lartë - nënkupton zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë”*, lidhur me nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.15, përkatësisht 1.36 të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, me të cilin është përcaktuar se: *“Për qëllimet e këtij ligji, lista e zyrtarëve të lartë është si më poshtë: [...] Kryesuesit dhe anëtarët e bordeve dhe drejtorët e përgjithshëm të ndërmarrjeve publike; [...], përkatësisht, [...] Udhëheqësit e të gjitha departamenteve, drejtorive, njësive të auditimit dhe njësive të barasvlershme, udhëheqësit e financave, buxhetit në të gjitha institucionet publike në nivelin lokal dhe qendror dhe në ndërmarrjet publike në nivelin lokal dhe qendror.*

Kësisoj, me dispozitat e LPKI-së, zyrtarit të lartë nuk i ndalohet që të ushtrojë njëkohësisht pozitën si ekspert për kontroll financiar në KQZ, dhe funksionin si anëtar i bordit të drejtorëve në KOSTT. Prandaj, në rastin konkret z. Mujovi në pozitën si ekspert për kontroll financiar në KQZ, ka të drejtë të jetë anëtar i organi drejtues të institucioneve të tjera publike, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 13 paragrafi 2 të LPKI-së.

Megjithatë, duhet pasur parasysh se gjatë ushtrimit të pozitës si ekspert për kontroll financiar në KQZ, dhe ushtrimit të funksionit publik si anëtar i bordit të drejtove në KOSTT, në rast se paraqitet ndonjë situatë e mundshme e konfliktit ‘rast për rast’ të interesit, atëherë është i obliguar ta deklaron dhe të tërhiqet nga vendimmarrja në rastin e caktuar, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 17 të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.


Po ashtu në këtë rast zyrtari ka për obligim të zbatoj rregullat e veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës. Në këtë kontekst, çështjet që lidhen me ndalesat apo kufizimet eventuale të përcaktuara me legjislacionin tjetër relevant, Rregulloren e Brendshme nr.05/2024/ Kodi i Etikës për Zyrtarët Publik në KQZ, dhe/apo me aktet tjera të brendshme normative të institucionit punëdhënës/mbikëqyrës sa i përket ushtrimit të njëkohshëm të pozitës/funksionit të lartpërmendur, të gjitha këto gjejnë zbatim brenda institucionit punëdhënës, në bashkëpunim dhe bashkëveprim me organet drejtuese/mbikëqyrëse si dhe autoritetin përgjegjës për çështje të parandalimit të konfliktit të interesit brenda institucionit.

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


YLLI BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

